

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Kërkim nëpërmjet projektimit: gjetja e mënyrave për të qënë elastik dhe të ripërtëritshëm ndaj fenomeneve natyrore.

Vendi i Testimit: Ishulli i Osumit, Berat

Afati Faza I: 4 Mars, 2015

Kërkesat Faza I: Deklarata e Përbërjes së Skuadrës, CV e Stafit Kryesor, Metodologjia, Deklarata e Vizionit



TERMAT E REFERENCËS

Promovues

Atelier Albania, me kërkesën e Bashkisë së Beratit dhe e mandatuar nga Zyra e Kryeministrit, po shpall nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një konkurs ndërkombëtar të 'kërkimit nëpërmjet projektimit' për të propozuar idenë e zhvillimit pejsazhistik të Ishullit të Osumit në Berat, si edhe për të gjetur mënyra për të qënë elastik dhe të ripërtëritshëm ndaj fenomeneve natyrore, duke e përdorur ishullin si vend testimi.

Manifesto

Zona e konkursit është njëkohësisht objekti i konkursit dhe zonë testimi. Është një ishull i vogël në një qytet relativisht të vogël të Shqipërisë por me një kontekst historik shumë unikal qendra historike e të cilit është sot pjesë e fondit të trashëgimisë kulturore të UNESCO-s. Për qytetin mund të thuhet shumë, por duke qënë se nuk i takon këtyre termave të referencës të japin shpjegime për kontekstin e qytetit, të gjitha këto detaje do të jenë pjesë e një dokumenti të veçantë që do të shoqërojë konkurentët në Fazën 2 të konkurimit.

Ishulli në vetvete, i cili është si vendi i projektit ashtu edhe vendi i testimit, është një territor i lënë mënjane dhe pasdore nga qyteti, por i cili sidoqoftë ndryshon formë e trajtë herë pas herë për shkak të luhatjeve të ujit në shtratin e Lumit Osum. Prezenca e fortë e këtij aseti në qytetin e Beratit na bën të mendojmë se ky ishull mund të transformohet dhe të kthehet vërtetë në qendër të vëmendjes publike për qytetin, por veçanërisht për zonat përreth tij. Ishulli meriton vëmendjen dhe mendimin e projektuesve që mund t'i japin formë potencialit të tij.

Nga ana tjetër, përgjatë historisë së tyre të përbashkët, ishulli dhe uji që rrjedh në brigjet e Lumit Osum, kanë qënë vazhdimisht në 'përleshjen për të përcaktuar territoret e tyre. Vetëm ditët e fundit, Shqipëria jugore përjetoj përsëri eksperiencën e hidhur të përmytjeve si edhe të shumë problematikave që e shoqërojnë. Megjithëse përmytja në vetvete nuk është një fenomen i ri, ajo përsëri i gjen të papërgatitur banorët e zonave që bëhen viktimë e saj dhe si rezultat përsëri kishim një inventar të konsiderueshëm dëmsh dhe pasojash.

Ky konkurs ndërkombëtar po shpallet me qëllimin për të lidhur Ishullin e Osumit në Berat me rrjetin e hapësirave të qytetit të Beratit. Kjo thirrje ndërkombëtare është në kërkim të mënyrave ku ajo ç'ka quhet urbane mund të bashkëjetojë me natyrën dhe të jetë njëkohësisht elastike dhe e ripërtëritshme kundrejt çdo fenomeni natyror.

Përmes kësaj thirrjeje të hapur, Atelier Albania, synon të tërheqë ekipe me arkitektë, pejsazhistë dhe dezajnera. Qëllimi është që të përftohen koncepte sa më origjinale dhe vizionare për ndërhyrje të karakterit arkitektonik dhe urban për vend-testimin Ishulli i Osumit në Berat, si edhe për zgjidhje inovative për zhvillimin e pejsazhit, e mbi të gjitha për një bashkjetese harmonike midis jetes urbane dhe thesarit natyror. Konceptet duhet të bazohen në parimet që gjenerohen dhe gjithashtu i përgjigjen veçantive të zonës, kërkesave të ushtrimit, si edhe nga parime që informohen nga eksperiencat e vendeve të tjera.

Përfituesit

Konkursi për Ishullin e Osumit në Berat është një vend-testim dhe kërkon mënyra për t'i dhënë vendeve tipare të elasticitetit dhe ripërtëritjes karshi fenomeneve natyrore. Ky konkurs kërkon të përdorë projektimin si një mjet për të kërkuar zgjidhjet më të mira të mundshme të ripërtëritjes në kushtet e zhvillimeve përgjatë brigjeve. Ky konkurs gjithashtu kërkon edhe mënyra të zhvillimit të pejsazheve natyrore dhe të përcaktimit të bashkëjetesës së asaj që mund të quhet urbane me natyrën.

Duke qënë se Ishulli i Osumit në Berat do të jetë edhe një vend-testimi, gjetjet e konkursit mund të përdoren edhe nga vende e kontekste të tjera të ngjashme, të cilat janë zona me rrezik përmbajtje dhe në mungesë të tipareve të ripërtëritjes dhe elasticitetit. Në këtë perspektivë, ky ushtrim shërben më shumë se sa kontakti i qytetit të Beratit. Propozimet mund të bëhen një burim frymëzimi për vende të tjera në Shqipëri apo edhe përtej kufijve të saj.

Autoriteti Kontraktues

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është autoriteti kontraktor në këtë proces, në emër të Qeverisë Shqiptare.

Objektivi

Produkti i konkursit do të jenë zgjidhjet e projektimit për zhvillimin e pejsazhit të Ishullit të Osumit në Berat. Konkurentët e përzgjedhur do të zbulojnë zgjidhjet më të mira të projektimit nëpërmjet ushtrimeve kërkimore, të cilat kanë për qëllim të hulumtojnë bashkëjetesën urbane pranë natyrës. Ata do të eksplorojnë mënyrat për të qënë elastik kundrejt fenomeneve natyrore dhe të ripërtëritshëm ndaj situatave të mundshme të përmbytjeve.

Konkurentëve të përzgjedhur u kërkohet të punojnë për të arritur, si më poshtë::

- Të studiojnë qytetin e Beratit dhe rrethinat e tij, programin e tij hapësinor dhe kontekstin kulturor,
- Të studiojnë Lumin Osum dhe sjelljen e tij gjatë situatave të ndryshme të rritjes së nivelit të ujit në shtratin e tij gjatë një shekulli,
- Të kërkojnë për kondicione të tjera të ngjashme përsa i përket rrezikut të përmbytjeve nga rritja e nivelit të ujrave të lumenjve, në Shqipëri, rajon, Evropë, apo në vende të tjera të botës,
- Të kërkojnë për mënyra se si mund të jetë arritur elasticiteti dhe ripërtëritja ndaj rreziqeve natyrore, në vende të tjera me kushte të ngjashme,
- Propozim për zhvillimin e pejsazhit të Ishullit të Osumit në Berat,
- Propozim se si qyteti i Beratit dhe Ishulli i Osumit mund të bëhen elastikë dhe të ripërtëritshëm ndaj fenomeneve të përmbytjes,
- Propozimi i ‘kutisë së veglave’ për territore të tjera mbarë Shqiptare pranë lumenjve apo detit, të rrezikuara nga përmbytjet,
- Parashikime të përafërta të kostove të secilit propozim,
- Propozim për një plan veprimi.

Çdo zgjidhje duhet të përcaktojë edhe një model të zbatueshëm në territore të tjera me kushte të ngjashme të rrezikut nga ndryshimet e klimës.

Çdo zgjidhje duhet të tentojë kufijtë e krijimtarisë duke u përshtatur ndërkohë me kontekstin lokal dhe duke vendosur standarde të larta të projektimit.

Zona e Konkursit

Zona e konkursit përcaktohet nga gjurma e Ishullit të Osumit në Berat, e cila ndryshon në varësi të sasisë së ujit që rrjedh në brigjet e Osumit. Ishulli pozicionohet mes bankinave ku janë vendosur dy lagjet më të vjetra dhe më të bukura që Berati ka sot, të cilat e kanë vendosur edhe në hartën e vendbanimeve botërore të ruajtura nga UNESCO. Ky ishull ka një prezencë mjaft të fortë në pejsazhin e lumit, por është lënë përherë 'pas dorë'. Gjatë viteve të para të 40-ës së shekullit të kaluar, arkitekti dhe planifikuesi italian Gherardo Bosio, propozoi në planin rregullues të hartuar prej tij për Beratin që bankinat e lumit të lidheshin nëpërmjet ishullit që shfaqet aty ku lumi zgjerohet më tepër se në pjesët e tjera të tij. Por vite më pas, lidhja e anëve të lumit për këtë pjesë të qytetit u realizua në jug të ishullit, atje ku lumi ngushtohet, duke e lënë në harresë ishullin në Osum, pavarësisht se prezenca e tij ka një ndikim të konsiderueshëm në pejsazhin e qytetit.

Qëllimi i Konkursit / Pyetja e Konkursit

Konkursi do të ngrihet mbi tre pyetje:

1. Të gjejë mënyra për zhvillimin e pejsazhit të Ishullit të Osumit në Berat
2. Të gjejë mënyra për të siguruar që territori buzë lumit është elastik dhe i ripërtëritshëm ndaj përmbytjeve të mundshme dhe sfidave të tjera të natyrës
3. Të zhvillojë zgjidhje nëpërmjet projektimit të cilat do të mbrojnë banorët e zonave me rrezik përmbytje nga sfidat që shkaktojnë ndryshimet e klimës.

Metodologjia

Atelier Albania është një njësi e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, e mandatuar për identifikimin e zgjidhjeve alternative dhe pasurimin e arkitekturës e planifikimit nëpërmjet të menduarit përtej kornizave. Në këtë kontekst ne stimulojmë dhe mbështesim pjesëmarrjen e grupeve me profesionistë ndërkombëtarë që do të punojnë së bashku me profesionistë vendas. Ne besojmë se ky bashkëpunim me bazë ekipi do të pasurojë mënyrën sesi informohet projekti me të gjitha njohuritë e nevojshme lokale dhe ekspertizën e nivelit të lartë të projektimit. Për më tepër, ne duam të eksperimentojnë një proces konkursi bashkë – krijues, ku projektuesit dhe disa aktorë lokalë janë të përfshirë në një proces interaktiv përzgjedhës.

Formati i konkursit është eksperimental në mënyrë që të kapërcehen ato që AA beson se janë çështje të pandara të proceseve tipike të konkurseve urbane dhe të arkitekturës.

Rezultatet e pritshme

FAZA 1:

në këtë fazë të short-listimit, kandidatët paraqesin veten e tyre duke ilustruar kapacitetet e tyre, metodologjinë dhe vizionet ndaj subjektit të konkursit. Çdo dorëzim do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe ekipet do të përzgjidhen bazuar në kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit të përmendura në Fazën 1.

Mes ekipeve të kualifikuara Juria do të short-listojë ekipet që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes së Fazës I. Këto ekipe do të thirren për të punuar gjatë një faze të dytë, për një koncept që do të synojë plotësimin e objektivit të konkursit dhe pyetjeve të konkursit, mbi bazën e një informacioni dhe të një detyre projektimi të detajuar

FAZA 2:

në këtë fazë të Skicë Idesë, secili grup i skicë-aplikimeve do të shqyrtohet me kujdes nga anëtarët e jurisë dhe, bazuar në kriteret të vlerësimit të Fazës 2, do të zgjidhet një ekip fitues.

Detyra e jurisë megjithatë nuk do të përfundojë me përzgjedhjen e ekipit fitues. Anëtarët vendas të jurisë si dhe anëtarët ndërkombëtarë me përvojë profesionale në Shqipëri do të bashkëpunojnë në krijimin e një fryme të vazhdueshme udhëheqëse e udhëzuese për ekipin fitues. Ekipi do të ketë rastin të takohet me anëtarët e jurisë për të diskutuar qëndrimin e tyre, zgjidhjet dhe impaktin e projektit. Ekipi duhet të bjerë dakord për të qëndruar mendje-hapur në drejtim të përshtatjes së projektit me situata të mundshme kontekstuale, për të cilat ai mund të mos ketë qenë në dijeni më parë. Juria do të luajë rolin e një këshilltari për fituesin, por edhe të partnerit për klientin në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e një projekti të mirë harmonizuar, i cili të ketë mbështetjen e aktorëve të ndryshëm dhe të premtojë një impakt të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë në zonën e ndërhyres. Takimi/et do të zhvillohen në Tiranë

Bashkimi i skuadrave vendase me të huajat

Çdo ekip ndërkombëtar stimulohet nga organizatorët për t'u lidhur në partneritet me një ekip vendas dhe çdo ekip lokal për t'u lidhur gjithashtu me një partner ndërkombëtar. Klienti beson se për të marrë projekte vizionare dhe kontekstuale ka një nevojë të qënësishme për vizionin e dikujt që nuk e njeh vendin dhe njohuritë kontekstuale të dikujt që e njeh mjaft mirë terrenin. Klienti beson se një bashkëpunim i tillë mund të rrisë ndikimin e propozimit dhe të përmirësojë zbatimin e projektit. Megjithatë, në thirrjen për fazën e parë, nuk është kusht përzgjedhje që ekipet të kenë një partner lokal apo ndërkombëtar.

Përshtatshmëria

Konkursi është i hapur për të gjithë profesionistët arkitektë, të cilët arrijnë të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. të jenë të regjistruar apo të njohur nga një organ zyrtar akreditimi në vendin e origjinës së aplikantit; ose
2. atje ku njohja apo regjistrimi nuk aplikohen me ligj, aplikanti të jetë anëtar i një institucioni profesional, në vendin e origjinës.

Të gjithë aplikantët duhet të japin dëshmi të vlefshmërisë së regjistrimit profesional, njohjes apo anëtarësit, në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Secili prej ekipeve të Fazës 1 duhet të ketë në përbërje një arkitekt, arkitekt pejsazhi, artist instalator ose artist pamor, inxhinier hidroteknik, dhe specialist të monumenteve të kulturës. Të gjithë anëtarët e Ekipit duhet të identifikohen në Deklaratën e Përbërjes së Skuadrës.

Detajimet jepen në shtojcën 6 të Dokumentit Standart të Tenderit. DST mund të përftohen elektronikisht në www.app.gov.al

Dokumente Aplikimi

Konkurentët duhet të dorëzojnë një seri me dokumente, në mënyrë që të jenë në përshtatje me kërkesat e konkurimit për fazën e parë dhe të dytë të konkursit.

Dokumentet e Fazës 1:

- Deklarata e Përbërjes së Skuadrës,
- CV të Stafit Primar,
- Metodologjia,
- Deklarata e Vizionit
- Të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme sipas përcaktimeve standarte të Agjencisë së Prokurimit Publik

Detajimet jepen në shtojcën 6 të DST.

Dokumentet e Fazës 2:

- Skicë-Ide

Kriteret e Kualifikimit

Juria do t'i zgjedhë aplikantët që do të vlerësohen gjatë fazës së parë bazuar mbi këto kriteret fillestare kualifikimi:

- Qartësia dhe plotësimi i dokumenteve të kërkuara në Fazën 1
- Përbërja profesionale e skuadrës (arkitekti, pejsazhisti, artisti, inxhinieri, specialisti i trashëgimisë)
- Eksperiencat e ngjashme të studios dhe stafit kyç
- Qartësia dhe efikasiteti i metodologjisë së propozuar
- Lidhja e vizionit të prezantuar me zgjidhjen e problematikave të përcaktuara në konkurs

Kriteret e Vlerësimit

Juria do të vlerësojë aplikimet e Fazës 2 bazuar në kriteret e mëposhtme:

- *Krijimtaria*
- *Faktori i lartë i zbatueshmërisë*
- *Lidhje dhe impakti i propozimit me kontekstin*
- *Raporti kosto-impakt (kosto e ulët, impakt i madh)*

Produkti Final

Konkursi do të përfundojë me zgjedhjen e një ekipi. Ekipi fitues duhet të jetë një ekip i mirë-pajisur, i cili do të jetë në gjendje të angazhohet në procesin pas-konkurs.

Skuadra fituese do të angazhohet në fazën tjetër, e cila konsiston në përgatitjen e studimit të fizibilitetit mbi bazën e propozimit fitues.

Modeli i zhvillimit që do të dorëzohet në përfundim nga skuadra fituese së bashku me studimin e fizibilitetit, do të shërbejë kryesisht si një platformë për të diskutuar ripërtëritjen e zonave të ngjashme buzë ujit. Produkti i konkursit do të shërbejë fillimisht për të zhvilluar vend-testimin e Ishullit të Osumit në Berat, i cili do të jetë projekti pilot, i shoqëruar me një 'kuti veglash' gati për të drejtuar procese të tjera të rasteve të ngjashme ku zona buzë ujit mund të zhvillohen apo rindërtohen nëpërmjet proceseve projektuese.

Procesi Post-Konkurs

Për të koordinuar më mirë punën mes skuadrës fituese dhe porositesit të projektit, organizatorët parashikojnë 1 takim mes skuadrës, klientit dhe grupeve të interesit, gjatë procesit të detajimit të projekt-idesë. Koncepti këtu është që aktorët të vijnë së bashku për të ndarë idetë, propozimet dhe sugjerimet e tyre, nën kujdesin e anëtarëve të Jurisë dhe institucioneve të specializuara. Ky takim do të realizohet në Tiranë ose në Berat.

Çmimet e Konkursit

Fituesi i konkursit do të vlerësohet me një çmim në vlerë monetare 15,000 Euro.

Do të ketë gjithashtu edhe një çmim të dytë prej 10,000 Euro, si edhe një çmim të tretë në vlerë monetare 5,000 Euro.

Skuadra fituese do të nisë negociatat e nënshkrimit të kontratës me Klientin për hartimin e studimit të fizibilitetit mbi bazën e projekt-idesë fituese. Vlera e kontratës së hartimit të studimit të fizibilitetit do të ketë vlerën 15,000 Euro.

Platforma e Konkursit

Lloji I Konkursit:	Konkurs Projektimi me Short-Listim
Faza 1:	Thirrje e Hapur për Shprehje Interesi
Kërkesat e Fazës 1:	Deklarata e Përbërjes së Skuadrës, CV e Stafit Kryesor, Metodologjia, Deklarata e Vizionit
Avantazh:	Bashkimi i studiove vendase dhe ndërkombëtare të Arkitekturës
Vlerësimi i Jurisë:	Lista e skuadrave të kualifikuara – ‘Lista e Shkurtër’
Phase 2:	Project-Idea/ sketch idea
Phase 2 Requirements:	Submission of project idea illustrations
In-between Phase:	Site visit and workshop with local stakeholders.
Jury Evaluation:	Best Design and fulfilment of criteria
Çmimet:	3 çmime Çmimi I: 15,000 Euro Çmimi II: 10,000 Euro Çmimi III: 5,000 Euro

Kalendari i Konkursit 2015

Thirrje e hapur për shprehje interesi:	10 Shkurt
Afati Faza 1:	4 Mars, ora 16.00
Lista e Shkurtër:	5-7 Mars
Ftesë për Projekt-Ide:	7 Mars
Përgatitja e Projekt-Idesë:	7 Mars – 3 Maj
Workshop në Berat/Tiranë:	11 Prill
Detyra finale e Projektimit + Plani i hapave:	7 Mars
Afati Faza 2:	3 Maj, ora 16.00
Prezantimet Publike:	4 Maj
Vlerësimi i Jurisë:	4 Maj
Shpallja e Fituesve:	11 Prill

Pas-Konkurs 2015

Negociatat e Kontratës	Maj 2015
Firmosja e Kontratës për Studimin e Fizibilitetit:	Maj 2015
Procesi i përgatitjes së Studimit të Fizibilitetit:	Maj – Korrik 2015
Takime me AA/Jurinë dhe Grupe Interesi:	5-6 Qershor
Dorëzimi i Studimit të Fizibilitetit:	15 Korrik

INFORMACIONE PROKURIMI

Faza e shortlistimit do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik në ndërfaqen me adresë:

www.app.gov.al.

Dokumentet e tenderit mund të përftohen elektronikisht në po këtë ndërfaqe:

www.app.gov.al.

Konkurentët e huaj, në mënyrë që të përdorin sistemin elektronik të prokurimit, duhet të regjistrohen on-line si një operator ekonomik në ndërfaqen:

<https://www.app.gov.al/ep/Registration.aspx>.

Instruksiione të mëtejshme për konkurentët ndërkombëtarë mund të merren nga manuali i përdoruesit "EPS user manual – Economic Operators", i cili mund të shkarkohet nga ndërfaqja

www.app.gov.al.

INFORMACIONE TË MËTEJSHME

Secili prej Termave të Referencës mund të gjenden edhe në faqen zyrtare të Organizatorit të Konkursit:

<http://www.planifikimi.gov.al>

Apo, në faqet e dedikuara për këto Konkurse:

<http://competitions.planifikimi.gov.al/beratisland/>

Mund të na kontaktoni edhe në:

berat.island@planifikimi.gov.al

Sqarimet lidhur me procedurën e prokurimit do të kërkohen vetëm nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.



AKPT
AGJENCIA KOMBETARE E
PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT



Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
Adresa: Rr. "Muhamet Gjollësja", Nr. 57
Kutia Postare 1023, Tiranë/ Shqipëri

www.turizmi.gov.al
info@turizmi.gov.al

www.planifikimi.gov.al
info@planifikimi.gov.al